



Одговорност, Технологија и Мрежа
на Институционална Отвореност
во Југоисточна Европа

Udhërrëfyes për qeverisje të mirë

për institucionet shtetërore në
Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në bazë të indeksit rajonal të shkallës së
hapjes së institucioneve shtetërore

Në bazë të
matjes për
vitin 2018

Shkup, korrik 2019



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian

METAMORPHOSIS



CRTA

ZaštoNe?



ODK
OPEN DATA KOSOVO



Projekti Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore – ACTION SEE, implementohet nga Fondacionit Metamorfozis, Fondacioni Westminster për demokraci, CRTA – Qendra për hulumtim, transparencë dhe llogaridhënie, Shoqata e qytetarëve “Why not?”, Qendra për tranzicion demokratik -CDT, Open Data Kosovo (ODK), dhe Lëvizja Mjaft!





Udhërrëfyes për qeverisje të mirë

për institucionet shtetërore në
Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në bazë të indeksit rajonal të shkallës së
hapjes së institucioneve shtetërore

Në bazë të matjes për vitin 2018

Shkup, korrik 2019

BOTUES:

METAMORPHOSIS 

Metamorfozis - Fondacioni për internet dhe shoqëri

Misioni i Fondacionit Metamorfozis është të kontribuojë në zhvillimin e demokracisë dhe ta rrisë cilësinë e jetës përmes përdorimit inovativ dhe shpërndarjes së njohurive. Vlerat tona kryesore janë transparenca, barazia dhe liria.

Adresa: Apostoll Gusllarot 40, 1000 Shkup,
Maqedonia e Veriut
Tel: +389 3109 325
Faksi: +389 3225 206
Ueb-faqja: www.metamorphosis.mk
E-mail-i: contact@metamorphosis.org.mk

PËR BOTUESIN:

Bardhyl Jashari

REDAKTORË:

Bardhyl Jashari
Milla Josifovska



Projekti ACTION SEE- Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore ka për qëllim ta rrisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në proceset e vendimmarrjes dhe krijimit të opinionit publik dhe hartimit të politikave, si dhe ta ngrisë kapacitetin e shoqërive civile për të zgjidhur çështje të ndjeshme.

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij publikimi përgjegjësi të vetme kanë partnerët e projektit ACTION SEE dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të supozohet se ai i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

KOORDINATOR I PROJEKTIT

Fondacioni Metamorfozis
Maqedonia e Veriut
Ueb-faqja: www.metamorphosis.org.mk

ORGANIZATAT PARTNERE:

Fondacioni për Demokraci - Westminster
Britani e Madhe
Ueb-faqja: www.wfd.org

CRTA - Qendra për Huluntim,
Transparenca dhe Përgjegjshmëri
Serbi
Ueb-faqja: www.crtars.rs

Shoqëria qytetare "Zashto ne?"
Bosnje dhe Hercegovinë
Ueb-faqja: www.zastone.ba

Qendra për Tranzicion Demokratik
Mali i Zi
Ueb-faqja: www.cdtmn.org

Open Data Kosovo (ODK)
Kosovë
Ueb-faqja: www.opendatakosovo.org

Lëvizja Mjaft!
Shqipëri
Ueb-faqja: www.mjajt.org

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

334.724.6:005.332.5(497.7)(047.31)

UDHËRRËFYES për qeverisje të mirë për institucionet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut : në bazë të indeksit rajonal të shkallës së hapjes së institucioneve shtetërore : në bazë të matjes për vitin 2018 / [redaktorë Bardhyl Jashari, Milla Josifovska]. - Shkup : Metamorfozis, 2019. - 32 str. ; 25 cm
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-263-024-3

а) Државни институции - Транспарентност - Македонија - Истражувања
COBISS.MK-ID 111891210

CPËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM | 7 |
| 2. INSTITUCIONET SHTETËRORE | 8 |
| 2.1. PUSHTETI EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 8 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 8 |
| 2.1.1. QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT | 9 |
| 2.1.2. MINISTRITË | 11 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 11 |
| 2.1.3. ORGANET E TJERA EKZEKUTIVE | 14 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 14 |
| 2.2. KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT | 15 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 15 |
| PËRMIRËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT GJATË MIRATIMIT TË LIGJEVE | 16 |
| PËRMIRËSIMI I TRANSPARENCËS FINANCIARE | 17 |
| MEKANIZMAT PËR KOMUNIKIM ME QYTETARËT DUHET TË PROMOVOHEN MË SHUMË | 18 |
| 2.3. GJYQËSIA | 20 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 20 |
| SHKALLA E HAPJES E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 20 |
| Qasja në drejtësi dhe në informacione me karakter publik | 21 |
| Efikasiteti ose njoftimi me punën e gjykatave | 21 |
| Efikasiteti ose njoftimi me punën e gjykatave | 21 |
| Shkalla e hapjes së prokurorive në Republikën e Maqedonisë së Veriut | 22 |
| 2.4. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE (KOMUNAT) NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 23 |
| PËRFUNDIMET KRYESORE | 23 |
| 3. METODOLOGJIA | 27 |
| 4. PROJEKTI: | 28 |
| 5. LEXONI MË SHUMË | 29 |



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Hapja është kusht kryesor për demokraci pasi që u mundëson qytetarëve t'i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efikase dhe përgjegjësinë e institucioneve për politikën që i zbatojnë. Institucionet në gjithë botën ndërmarrin aktivitete konkrete për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve.

Qeverisja e hapur bazohet në katër parime organizative: transparencë, qasje, integritet dhe vetëdije. Këto parime zbatohen në të gjitha degët dhe nivelet e pushtetit, nga pushteti ekzekutiv qendror deri tek vetëqeverisja lokale, kuvendi dhe gjyqësia.

Indeksi i shkallës së hapjes është një tregues i përbërë që e mat shkallën në të cilën qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë dhe është dizajnuar për ta përcaktuar shkallën në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacione të dobishme dhe të kuptueshme nga institucionet e tyre.

Për të matur shkallën e hapjes institucionale, partnerët e ACTION SEE, duke iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare, rekomandimeve dhe shembujve të praktikës së mirë, i vlerësuan institucionet përmes treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë, të cilët i vlerësojnë institucionet në bazë të: qasjes në informacionin që janë në dispozicion në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, cilësisë së kornizës ligjore për rastet individuale, burime të tjera

të informimit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

A u përgjigjën institucionet në pyetësorët e dorëzuar ishte një tregues shtesë i shkallës së hapjes së tyre. Shumë institucione morën rezultate negative për sa i përket treguesve sepse nuk iu përgjigjën pyetësorit, që është gjithashtu me rëndësi për t'u përmendur për dy arsye: së pari, sepse përgjegjësia institucionale është një tregues i hapjes dhe së dyti, se papërgjegjësia e institucioneve ka ndikim negativ në rezultatin e tyre, sepse ato u vlerësuan automatikisht me 0. Përveç kësaj, disa prej treguesve mund të vlerësoheshin pozitivisht vetëm nëse ekziston zbatimi i ligjeve ekzistuese.

Matja është realizuar nga dhjetori i vitit 2018 deri në fund të marsit të vitit 2019. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, të dhënat dhe gjetjet u zhvilluan një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për institucionet. Hapat e rekomanduar për secilën kategori të institucioneve bëhen në bazë të treguesve që nuk janë përmbushur plotësisht.

Duke pasur parasysh se janë vlerësuar disa kategori të caktuara të institucioneve, siç janë: organet ekzekutive, vetëqeverisjet lokale, gjykatat dhe prokuroritë publike, rekomandimet dhe hapat e veprimit për këto institucione janë të përgjithshme dhe vlejné për gjithë grupin e institucioneve.

Lexuesit mund ta lexojnë metodologjinë dhe informacionin e përgjithshëm për projektin në fund të këtij publikimi.



2. INSTITUCIONET SHETËRORE

2.1. PUSHTETI EKZEKUTIV NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

PËRFUNDIMET KRYESORE

Pushteti ekzekutiv¹ në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmbush 39% të treguesve të shkallës së hapjes, analizuar sipas fushave të transparencës, qasjes, integritetit dhe efikasitetit. Në këtë vlerësim mesatar të përmbushjes së treguesve të shkallës së hapjes janë përfshirë qeveria, e cila përmbush 78% të treguesve, ministrinë, të cilat përmbushin 52% të treguesve dhe një përmbushje modeste prej 29% e treguesve nga organet e administratës shtetërore. Prandaj, konstatohet se angazhimi dhe përkushtimi i ndaj standardeve të hapjes është në nivele të ndryshme në strukturat e ndryshme të pushtetit ekzekutiv, ashtu sikurse edhe vitin e kaluar. Për më tepër, në drejtim të njëjtë janë edhe përfundimet e vëzhgimit² të gatishmërisë (hapjes) për të shkëmbyer informacione mbi realizimin e aktiviteteve të Strategjisë për reformës të administratës publike 2018-2022³, ku shfaqen dallime nga institucioni në institucion.

Për ta kapërcyer këtë situatë, qeveria identifikoi nevojën për të krijuar një Strategji të re për transparencë të qeverisë⁴ cila bazohet në rekomandimin për zgjidhjen sistematike të konceptit të hapjes që është dhënë në Planin gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë për institucionet shtetërore në vend⁵. Kjo Strategji duhet t'i përcaktojë fushat prioritare dhe të ofrojë udhëzime për transparencën e qeverisë dhe të ministrive, si dhe për organet e tjera të administratës shtetërore (që janë përgjegjëse ndaj qeverisë).

Përmes një procesi të konsultimit u përgatit propozimi për Ligj të për qasje të lirë në informatat me karakter publik⁶. Në të është rregulluar angazhimi nga Strategjia për reformë të administratës publike për t'i forcuar mekanizmat për vënien në dispozicion të informatave me karakter publik, si dhe forcimi i kapaciteteve dhe i kompetencave të

1 Në këtë hulumtim, termi pushtet ekzekutiv përfshin qeverinë, ministrinë dhe organet e administratës shtetërore.

2 Gjetet në http://fosl.mk/CMS/Files/Documents/foom_reforma%20na%20javната%20administracija_MKD_web.pdf, f.24 (qasja e fundit më 12.07.2019)

3 Gjetet në <http://www.mio.gov.mk/?q=mk/node/1587>

4 Përfundimi i Qeverisë së RMV-së, gjetet në dispozicion në file:///C:/Users/ddani/Downloads/126_sednica_na_vlada.pdf, fq. 31 (qasur për herë të fundit më 12.07.2019)

5 Gjetet në http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/12/Action_SEE_MK_roadmap_MKD_final_2018.pdf

6 Gjetet në <https://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=1dd69278-137a-4f6d-aad7-e07d-5a23b131>

7 Transparenca aktive (ose haset edhe si transparencë proaktive) nënkupton detyrimin (obligimin) për poseduesit e informatave për t'i vënë në dispozicion informatat që dalin nga kompetencat dhe puna e tyre. Ligji për qasje të lirë në informatat me karakter publik e rregullon këtë detyrim të poseduesve të informatave me karakter publik në nenin 10.

8 Gjetet në <https://www.vlada.mk/komunikaciska-strategija> (qasur për herë të fundit më 17.07.2019)

9 Gjetet në <http://mioa.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership>

10 Gjetet në <https://opennessindex.actionsee.org/storage/files/Macedonia/Executive%20branch/Otvorenost%20na%20instituciite%20na%20izvrsnata%20vlast%20vo%20regionot%20i%20Makedonija.pdf>

11 Programi i punës së qeverisë 2017-2020, gjendet në http://www.vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Programa_Vlada_2017-2020_MKD.pdf

12 Gjetet në <http://budget.finance.gov.mk/>

organit të shkallës së dytë, i cili vendos për ankesat në rastet kur qasja e lirë në informata është e kufizuar.

Përveç kësaj, qeveria u përkushtua për konceptin e transparencës dhe llogaridhënie aktive⁷ të të gjitha institucioneve qeveritare ndaj qytetarëve dhe e përgatiti dhe e publikoi Strategjinë e komunikimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2019-2020⁸. Detyrimet për transparencë aktive janë përcaktuar edhe në planet kombëtare aksionale të Partneritet për Qeveri të Hapur⁹. Prandaj mund të konkludohet se hapi i veprimt për ta përmirësuar transparencën aktive, të rekomanduar në Planin gjithëpërfshirës për qeverisje të mirë për institucionet shtetërore në vend është mishëruar në disa dokumente strategjikë të Qeverisë, nga zbatimi i të cilave do të varet përmirësimi i ardhshëm në përbushjen e treguesve të shkallës së hapjes të organeve të administratës shtetërore dhe të ministrive, dhe afrimi i tyre me indeksin e veçantë të qeverisë.

2.1.1. QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Sipas indeksit të shkallës së hapjes Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në vendin e dytë në rajon dhe ajo përbush 78% të treguesve. Shikuar nga aspekti rajonal, rezultati është shumë i mirë, sepse dy vjet më parë ajo ishte në vendin e fundit në rajon me vetëm përbushje prej vetëm 52% të treguesve.¹⁰, e kjo po ashtu korrespondon me përkushtimin e qeverisë për ta avancuar shkallën e hapjes¹¹.

Është krijuar një ueb-faqe e ridizajnuar e qeverisë me një seksion “Qeveria e Hapur”, ku është publikuar veçmas Buxheti i qeverisë për vitin aktual, e po ashtu janë publikuar edhe buxhetet, rebalancet e buxheteve dhe llogaritë përfundimtare për dhjetë vitet e fundit. Më tej, vazhdoi praktika e publikimit të planeve për furnizime publike në ueb-faqen e Qeverisë për vitin 2018 dhe 2019 vazhdoi me ndryshime dhe plotësime, si dhe praktika e publikimit të Buxhetit të qytetarëve¹² të shtetit me mundësinë që qytetarët ta kuptojnë buxhetin e vitit 2019 përmes shpjegimeve grafike dhe narrative.




Anketa e këtij viti tregoi se përmirësimi i planifikuar i portalit ekzistues për të dhënat e hapura ka përfunduar, ndërsa është lëshuar në përdorim edhe portali i ri data.gov.mk.



Kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e qytetarëve, është konstatuar se qeveria ka vazhduar t'i zbatojë rregullat e përcaktuara për përfshirjen e palëve të interesuara në krijimin e politikave, për shembull duke vazhduar t'i mbajë Ditët e hapura për iniciativa të organizatave qytetare¹³; Këshilli i themeluar i qeverisë për bashkëpunim me dhe zhvillimin e sektorit civil¹⁴ ka punuar në mënyrë aktive gjatë vitit të kaluar dhe e krijoi Propozim-modelin për përfshirjen e organizatave qytetare në procesin e negociatave me BE-në¹⁵; përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile marrin pjesë në grupet e punës për krijimin e politikave të reja.

Vazhdoi praktika e publikimit të dokumentit që i përmban masat dhe ndryshimet që janë realizuar në dy vitet e para të mandatit të qeverisë¹⁶, por në të nuk janë shënuar shumat e mjeteve të shpenzuara/të siguruar për masat, e as ndryshimet në lidhje me zërat buxhetorë, nga të cilat janë bërë shpenzimet. Duke pasur parasysh se raportet vjetore për punës e qeverisë është një nga instrumentet kryesore të shkallës së hapjes, por edhe për kontrollin e punës nga ana e qytetarëve, qeveria duhet ta publikojë një dokument të tillë në të ardhmen.

HAPAT E VEPRIMIT

-  Formati i informatave të publikuara buxhetore në ueb-faqen e qeverisë megjithatë duhet të përmirësohet, nga PDF në një format të hapur, duke pasur parasysh se një praktikë e tillë e publikimit tashmë është krijuar nga Ministria e Financave¹⁷.
-  Edhe pse në seksionin e ri "Qeveria e hapur" janë publikuar edhe Kontratat e lidhura për furnizime publike¹⁸ të qeverisë në dy vitet e fundit, në të ardhmen këto kontrata duhet të publikohen në kohë në ueb-faqen e qeverisë, pasi në 6 muajt e fundit nuk është publikuar asnjë kontratë për furnizim publik, ndërsa ndërkohë edhe dhjetë kontrata haset shtesë janë lidhur dhe janë publikuar në Sistemin elektronik për furnizime publike.¹⁹
-  Në ueb-faqen e qeverisë duhet të publikohen dokumentet e shqyrtuara në mbledhjet e qeverisë, si dhe dokumentet e miratuara nga Qeveria, të cilat më pas publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

13 Informatat janë në dispozicion në <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=node/315>

14 Më shumë informata ka në <http://nvosorabotka.gov.mk/?q=node/99>

15 Raporti vjetor i punës së Këshillit për vitin 2018, gjendet në https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/2.1.Nacrt-izvestaj%20za%20rabota%20na%20Sovetot%202018%20korekcija_0.pdf

16 Gjendet në <https://vlada.mk/2GodiniOdgovorno>

17 Gjendet në <https://www.finance.gov.mk/mk/node/575>, (qasur për herë të fundit më 19.07.2019)

18 Gjendet në <https://vlada.mk/javni-nabavki>

19 Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me legjislacionin, sistemi elektronik për furnizime publike është i vetmi sistem informacioni i disponueshëm në internet, i cili përdoret për të mundësuar efikasitet, transparencë dhe efektivitet në fushën e furnizimeve publike. Gjendet në <https://e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/home.aspx#/contracts/0>

20 GRECO - rrethi i pestë i vlerësimit në temën "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit të pushteti qendror (funksionet më të larta ekzekutive) dhe organet e zbatimit të ligjit" gjendet në <https://vlada.mk/node/18341> (qasur për herë të fundit më 20.07.2019)

21 pika 107 në GRECO - rrethi i pestë i vlerësimit në temën "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit të pushteti qendror (funksionet më të larta ekzekutive) dhe organet e zbatimit të ligjit" gjendet në <https://vlada.mk/node/18341> (qasur për herë të fundit më 20.07.2019)

22 Gjendet në <https://vlada.mk/2GodiniOdgovorno>

- ☞ Duhet të rritte shkalla e pavarësisë dhe kapacitetet e Komisionit për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, si dhe kompetencat e saj për zbatimin e ligjit.
- ☞ ENER-it në të ardhmen duhet t'i mundësohet të paraqesë iniciativa dhe propozime onlajn nga palët e interesuara me mekanizëm për përgjigje kthyesë dhe konsultimin e tyre.
- ☞ Me qëllim të përmbushjes së standardeve të integritetit, si dhe në përputhje me rekomandimet e dhëna në rrethin e pestë të vlerësimit të GRECO-s²⁰ për Maqedoninë e Veriut, qeveria në të ardhmen duhet të bëjë "analizë të zbatimit praktik të sistemit të sanksioneve në lidhje me shkeljet e rregullave të konfliktit të interesit, integritetit dhe anti-antikorrupsionit dhe të kujdeset që sanksionet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.²¹".
- ☞ Rekomandohet që në ueb-faqen e qeverisë të publikohet plan për integritet ose cila do qoftë politikë tjetër e brendshme për luftë kundër korrupsionit, e cila përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike brenda institucionit.
- ☞ Dokumenti që i përmban masat dhe ndryshimet që janë realizuar në dy vitet e para të mandatit të qeverisë²², duhet t'i përmbajë edhe shumat e mjeteve të shpenzuara/të siguruara për masat dhe ndryshimet e bëra në zërat buxhetorë, nga të cilat janë bërë shpenzimet.

2.1.2. MINISTRITË

PËRFUNDIMET KRYESORE

Ministritë në Maqedoninë e Veriut kanë një përmbushje mesatare prej 52% të treguesve të shkallës së hapjes. Ky rezultat është përafërsisht i njëjtë me shkallën e hapjes së ministrive në shumicën e vendeve të rajonit. Megjithatë, përmbushja e treguesve të hapjes së ministrive në vend fillon nga 23% në Ministrinë e Kulturës, që është dy herë më e ulët se mesatarja e indeksit të shkallës së hapjes së ministrive, e deri te



ministrinë që kanë rezultat më të mirë, edhe atë Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë me 68%. Në vendin e dytë është Ministria e Punëve të Brendshme me 66%, ndërsa në vendin e tretë është Ministria e Mbrojtjes me përbushje të treguesve të hapjes prej 64%.

Ministrinë, mesatarisht, e përbushin 63% të indeksit të transparencës, për përbushjen e të cilit ndikojnë informatat e publikuara në lidhje me buxhetet e ministrive (68%), informatat që lidhen me strukturën organizative të ministrive (67%) dhe informatat për furnizimet publike²³ (45%). Ato e tejkalojnë mesataren e rajonit me përbushje të treguesve për transparencë prej 56%, pasi ligji i detyron ata të publikojnë informacione edhe në ueb-faqe të tjera. Nga rekomandimet e dhëna vitin e kaluar²⁴, në mënyrë që ministrinë të publikojnë plane të prokurimit publik, thirrje të hapura dhe zgjidhje të prokurimit publik në faqet e tyre të internetit, një praktikë e tillë është krijuar këtë vit dhe të gjitha ministrinë kanë publikuar plane të furnizimit në ueb-faqet e tyre, ndërsa gjysma e ministrive ende nuk kanë publikuar thirrjet e hapura (shpalljet) dhe/ose vendimet për furnizime publike në ueb-faqet e tyre.

Në përputhje me rekomandimin e mëparshëm janë edhe rekomandimet për publikimin e informatave në lidhje me buxhetin në ueb-faqet e të gjitha ministrive, të cilat vitin e kaluar u obliguan nga qeveria t'i publikojnë buxhetet e tyre, si pjesë e listës së 21 dokumenteve të detyrueshme në ueb-faqet e tyre. Ministria e Financave i publikon të gjitha informatat që lidhen me shkallën e hapjes së buxheteve dhe prandaj është vlerësuar me 99%, ndërsa këtë vit rezultate të shkëlqyeshme kanë edhe Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ministria e Transportit. Vetëm Ministria e Kulturës nuk publikon informacione në këtë kategori dhe për këtë arsye është vlerësuar me 0%.

Për sa i përket përbushjes së indeksit të qasjes në nënkategorinë qasja në informata, ministrinë plotësojnë 55% të treguesve, që është afër mesatares së rajonit prej 50%, por ende paraqet indikator për mungesë të publikimit aktiv të informatave. Indeksin e integritetit ministrinë e përbushin me 43% për shkak se sikurse edhe vitin e kaluar, asnjë

Ministrinë, mesatarisht,
e përbushin

63%
të indeksit të
transparencës

99%
Ministria e Financave i publikon
të gjitha informatat që lidhen me
shkallën e hapjes së buxheteve dhe
prandaj është vlerësuar me

²³ Në kuadër të hulumtimit të realizuar në periudhën nëntor 2018-shkurt 2019, u vlerësua se a janë publikuar thirrjet për furnizime publike, kontratat, shtojcat dhe vendimet e përzgjedhjes për furnizimet e realizuara publike, si dhe planet për furnizime publike.

²⁴ "Udhërrëfyes për qeverisje të mirë për institucionet shtetërore" Gjetendet në <https://bit.ly/2lO56nv>

37%

vetëdija e ministrive

50%

e ministrive nuk përdorin tregues për matjen e performancës

ministri nuk në ueb-faqen e saj nuk ka publikuar plan për integritet ose ndonjë politikë tjetër e brendshme për luftë kundër korrupsionit (e cila përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe joetike brenda institucionit).

Ministritë janë më të dobëtat në përmbushjen e treguesve për efikasitet me 37%, ndërsa në nënkategorinë e monitorimit dhe vlerësimit të politikave ato plotësojnë një përqindje modeste prej 33% të treguesve. Të pyetur nëse përdorin tregues të matjes së performancës kur hartojnë plane dhe raporte vjetore të punës, 1/2 e ministrive u përgjigjën negativisht, gjegjësisht se nuk përdorin.

HAPAT E VEPRIMIT

- ☒ Rekomandohet që të gjitha ministritë t'i publikojnë thirrjet e hapura (shpalljet) dhe/ose vendimet për furnizime publike në ueb-faqet e tyre me qëllim që t'i përmbushin standardet kombëtare për transparencë.
- ☒ Kur bëhet fjalë për publikimin e informacionit për buxhetin në ueb-faqet e tyre, ministritë duhet ta ndjekin dhe ta respektojnë rekomandimin e qeverisë për publikimin e 21 dokumenteve të detyrueshme.
- ☒ Me qëllim që të plotësohen treguesit për parandalimin e konfliktit të interesave, ministritë duhet t'i publikojnë deklaratat për pasurinë e funksionarëve në ueb-faqet e tyre dhe të dërgojnë linke në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, ku deklaratat e përmendura vendosen në përputhje me ligjin.
- ☒ Ministritë duhet të përqendrohen në krijimin dhe përdorimin e treguesve për matjen e performancës gjatë përgatitjes së planeve dhe raporteve vjetore të punës.



2.1.3. ORGANET E TJERA EKZEKUTIVE

PËRFUNDIMET KRYESORE

Shkalla e hapjes së organeve të tjera ekzekutive është në nivel të ulët në të gjitha vendet e rajonit dhe ndryshojnë nga 26% deri në 43% të përmbushjes së treguesve. Shkalla e hapjes së organeve ekzekutive në Republikën e Maqedonisë së Veriut është vlerësuar me 29% të përmbushjes së treguesve.

Individualisht, të analizuar sipas fushave në katër nënkategoritë e indeksit të shkallës së hapjes, ato plotësojnë 39% të treguesve për transparencë, vetëm 20% të treguesve për qasje, treguesit për efikasitet përmbushin vetëm me 7% kurse përmbushja e treguesve për integritet është jashtëzakonisht e ulët me 3%. Përmbushja e ulët e indeksit të integritetit do të thotë se, njësoj sikurse në vitin 2017, ashtu edhe në vitin 2018, ata nuk publikojnë asnjë informacion mbi obligimet e marra përsipër dhe realizimin e trajnimeve për punonjësit për çështje të konfliktit të interesave, parandalimin e korrupsionit, raportimin e rasteve të korrupsionit, etj.

Pjesa më e madhe e organeve të tjera ekzekutive nuk i publikojnë të dhënat për furnizimet publike në ueb-faqet e tyre, e as nuk kanë link deri te sistemi elektronik për furnizime publike, prandaj vlerësimi i përgjithshëm për përmbushjen e treguesve për transparencë në nënkategorinë e furnizimeve publike është vetëm 23%. Për sa i përket publikimit të informatave në lidhje me buxhetin, 51% i plotësojnë treguesit, që do të thotë se disa nga organet e tjera ekzekutive e kanë publikuar buxhetin vjetor dhe raportin gjysmëvjeçar të shpenzimeve buxhetore. Informatat për vendosjen organizative janë të pamjaftueshme dhe kontribuojnë për përmbushjen e treguesve prej 41%.

Duke pasur parasysh se përmbushja e treguesve për qasjen në informata është 26%, që është dukshëm më e ulët se niveli i përmbushjes së qeverisë (83%) dhe e ministrive (55%), konfirmohet nevoja e shprehur për të krijuar një Strategji të re për transparencë të qeverisë²⁵, e cila do të bazohet në rekomandimin²⁶ për zgjidhjen sistematike të konceptit të hapjes dhe do t'i përfshijë qeverinë, ministritë, por edhe organet e tjera ekzekutive.

29%

shkallë e hapjes
së organeve
ekzekutive

26%

qasja ne
informata

²⁵ Përfundimi i Qeverisë së RMV-së, gjendet në file:///C:/Users/ddani/Downloads/126_sednica_na_vlada.pdf dispoziçion në, fq. 31 (qasur për herë të fundit më 12.07.2019)

²⁶ Rekomandimi është dhënë në Udhërrëfyesin për qeverisje të mirë për institucionet shtetërore në vend. Gjendet në http://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2018/12/Action_SEE_MK_road-map_MKD_final_2018.pdf

27 E Kodi etik për sjelljen e deputetëve në Kuvendin e RM- <http://sobranie.mk/materialdetails.aspx?material-id=6313a878-faf4-4b55-8c52-9c7d793da203>

28 Institucioni e pranoi iniciativën për të ashtuquajturin proces të Zhan Monesë, të iniciuar nga tre eurodeputetët Ivo Vajgël, Eduard Kukan dhe Knut Flekenshtajn, që kishte për qëllim përfshirjen më të madhe të Kuvendit në proceset e eurointegruese të vendit; Masat për përmirësimin e ambientit demokratik të Kuvendit ishin pjesë e Planit 3 - 6 - 9 (<http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>), i cili ishte një plan për zbatimin e reformave urgjente prioritare të Komisionit Evropian dhe rekomandimeve të grupit të ekspertëve të udhëhequr nga Pribe; Kuvendi ishte pjesë e projektit për forcimin e kapaciteteve të Kuvendit që kishin për qëllim përmirësimin e kornizës rregullatore dhe institucionale të Kuvendit, të financuar nga BE-ja dhe iniciativa të tjera.

29 Në vitin 2016, shteti ishte në një rën nga krizat më të thella politike dhe institucionale, dhe në fund të vitit u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare, në të cilin pas më shumë se 10 viteve u ndryshua përbërja parlamentare. Një vit më pas, Kuvendi u bllokua nga opozita për shkak të përcaktimit të paraburgimit për gjashtë deputetë të opozitës, për të cilët zhvillohej procedurë gjyqësore për përfshirje në hyrjen e dhunshme në Kuvend më 27 prill të vitit 2017, si reagim ndaj kryetarit të sapozgjedhur të Kuvendit. Vitin 2018 e shënoi ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, me të cilën u zgjodh kontesti që zgjati me dekada midis dy vendeve për çështjen e emrit. Pas ratifikimit të Marrëveshjes pasoi një proces i gjatë dhe i vështirë i ndryshimeve kushtetuese, me të cilat u zyrtarizua emri i ri i shtetit - Republika e Maqedonisë së Veriut.

HAPAT E VEPRIMIT

- ✚ Autoritetet e tjera ekzekutive duhet t'i publikojnë dokumentet e brendshme për luftë kundër korrupsionit dhe dokumentet që përmbajnë informacione në lidhje me monitorimin, vlerësimin dhe raportet mbi punën e tyre.
- ✚ Rekomandohet që organet e tjera ekzekutive në ueb-faqet e tyre t'i publikojnë dokumentet e tyre që kanë të bëjnë me furnizimet publike dhe të publikojnë linke deri te sistemi elektronik për furnizime publike.
- ✚ Duhet të vendoset një procedurë onlajn për pranimin e ankësive dhe vërejtjeve nga qytetarët në lidhje me punën e organeve të tjera ekzekutive, me qëllim që të parandalohet komunikimi i dobët me qytetarët dhe sasia e vogël e informatave publike të publikuar në ueb-faqe pa i kërkuar ato.

2.2. KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

PËRFUNDIMET KRYESORE

Shkalla e hapjes së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është përmirësuar shumë pak në krahasim me vitin 2018. Duke përbushur 66% të treguesve të shkallës së hapjes, kjo bie saktësisht në mesataren rajonale të shkallës së hapjes prej 66%.

Këto të dhëna tregojnë se Kuvendi ka zbatuar një pjesë të parëndësishme të rekomandimeve të këtij hulumtimi që janë dhënë gjatë dy viteve të fundit. Miratimi i Kodit etik për sjelljen e deputetëve²⁷ në vitin 2018 është pothuajse i vetmi tregues i transparencës aktive që e ka zhvendosur hapjen aktive të Kuvendit në tre vitet e fundit. Megjithatë, edhe përkundër përparimit të dobët, Kuvendi është në vendin e dytë për nga shkalla e hapjes së institucioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, menjëherë pas qeverisë, e cila përbush 78% të treguesve për shkallën e hapjes. Duket se edhe përkundër disa iniciativave²⁸ të Kuvendit për t'u angazhuar për përmirësimin e transparencës, funksionalitetit dhe besueshmërisë së institucionit, konteksti i vazhdueshëm shoqëror dhe krizat politike²⁹ ndikojnë në këto procese, siç janë për shembull



ndryshimet në Rregulloren e punës, pasi që është ndryshimin e saj tashmë një kohë të gjatë nuk mund të arrihet kompromis ndërmjet partive parlamentare.

Kuvendi i zbaton praktikat e mira të vendosura të hapjes së tij, gjegjësisht vazhdon t'i publikojë rregullisht kalendarët e seancave dhe agjendat e punës për seancat plenare dhe organet e punës, video-incizimet dhe stenogramet e seancave plenare, prezencën dhe mënyrën e votimit të deputetëve në seancat plenare, kontaktet dhe biografite të deputetëve, si dhe rregullisht publikon raporte të hollësishme vjetore.

Sa i përket cilësisë së procesverbaleve të përgatitura vërehet përparim, por vetëm në punën e një numri të vogël të komisioneve.³⁰

PËRMIRËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT GJATË MIRATIMIT TË LIGJEVE

Kuvendi shënon rritje të treguesve në lidhje me proceset konsultative gjatë miratimit të ligjeve në 88%, për shkak të mënyrës në të cilën Kuvendi është përgjigjur në pyetësorët. Duke pasur parasysh mundësinë që e ofron Rregullorja e punës që ekspertë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të marrin pjesë në mbledhjet e organeve punuese, Kuvendi jep vlerësime pozitive për mekanizmat konsultues.

Në kuadër të iniciativës për Kuvend të hapur, vetë institucioni konkludon se ka mungesë të rregullimit në Rregulloren e punës për pjesëmarrjen e qytetarëve në punën e Kuvendit, se nuk shfrytëzohet sa duhet mekanizmi i seancave mbikëqyrës, si dhe se nuk ka mundësi që qytetarët të marrin pjesë në to.³¹ Për ta përmirësuar procesin e konsultimit, Kuvendi ka paraparë katër arritje në periudhën 2019-2021, edhe atë: (1) rritje e përqindjes së organeve të punës që kanë përfshirë ekspertë në punën e tyre deri në 30%; (2) miratim i aktit për rregullimin e seancave të mbikëqyrjes; (3) miratim i planit për seanca të mbikëqyrjes; (4) rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe organizatave qytetare në seancat e organeve të punës deri në 70%.

Për më tepër, karakteristikë e disa përbërjeve parlamentare ishte që ligjet të miratohen në procedurë të shkurtuar, por kjo praktikë ngadalë po braktiset në vitin 2018. Miratimi i ligjeve me procedurë të shkurtuar duhet të përdoret në mënyrë të kufizuar, edhe atë vetëm në kuadër të kushteve të parapara me Rregulloren e punës, sepse afatet e shkurtuara

Kuvendi shënon rritje të treguesve në lidhje me proceset konsultative gjatë miratimit të ligjeve në

88%

³⁰ 5Raporti i pestë për indeksin e llogaridhënies, transparencës dhe produktivitetit të Kuvendit për periudhën 1 janar - 31 mars 2018, http://most.org.mk/wp-content/uploads/2017/07/Index-Report-5_ENGFinal.pdf

³¹ Po aty

të procedurës e zvogëlojnë edhe më shumë mundësinë për procese cilësore konsultuese.

Ajo që është e pazakontë për vitin 2018 është fakti se deputetët paraqiten si propozues të ligjeve në pothuajse 50% të ligjeve të miratuara. Ligjet që vijjnë në Parlament si propozim i Qeverisë pritet ta kenë kaluar procesin e nevojshëm të konsultimeve në përputhje me Rregulloren për punë të qeverisë³². Aktiviteti i shtuar dhe propozimi i ligjeve nga deputetët do të thotë se ky mekanizëm i detyrueshëm për konsultim i qeverisë nuk është realizuar dhe, aq më tepër, nënkupton miratimin e dispozitave në Rregulloren e punës ose miratimin e akteve të tjera të brendshme me të cilat do të garantohen konsultimet për propozim-ligjet me palët e interesuara.

PËRMIRËSIMI I TRANSPARENCËS FINANCIARE

Treguesit për shkallën e hapjes sa i përket buxhetit të shtetit shënojnë rritje prej 11% në krahasim me vitin e kaluar, por me përmbushje prej vetëm 38%, ato ende paraqesin segmentin më të dobët në spektrin e informata që i publikon Kuvendi në ueb-faqen e tij. Kuvendi ka praktikë që ta publikojë propozim-buxhetin e shtetit, por jo edhe buxhetin përfundimtar të votuar ose raportet gjysmë-vjetore për shpenzimin e buxhetit, llogarinë përfundimtare apo buxhetin e qytetarëve.

Publikimi i të dhënave për transparencën financiare është njëra nga masat për të cilën Kuvendi ka paraparë angazhim në kuadër të iniciativës për Partneritet të hapur qeveritar - Kuvendi i hapur, ku është vërejtur nevoja për ta rritur transparencën financiare dhe autonominë buxhetore të Kuvendit, vërehet mospublikimi i planit për furnizime publike të Kuvendit, detaje të pamjaftueshme të buxhetit të Kuvendit dhe mosvënja në dispozicion e raporteve për ekzekutimin e buxhetit të Kuvendit³³.

Treguesit për qasjen në informata po ashtu janë rritur shumë pak në krahasim me vitin e kaluar, por në ueb-faqen e Kuvendit ende nuk ka informata për personin përgjegjës për qasje në informatat me karakter publik, ndërsa lista e informatave me karakter publik nuk është azhurnuar. Në këtë segment, sipas rezultateve të hulumtimit, është vënë re se ka shpërndarje të pamjaftueshme të përmbajtjeve nga puna e Kuvendit me publikun; shpërndarje të pamjaftueshme të të gjitha

32 Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nen 66 <https://bit.ly/2kcZm6w>

33 Gjetet në <http://www.mioa.gov.mk/?q=mk/documents/open-government-partnership>



dokumenteve relevante në lidhje me procesin legjislativ; informata të pamjaftueshme që janë publikuar për votimin e deputetëve në Kuvend, dhe mospërshtatjen e ueb-faqes së Kuvendit për qasje nga personat me shikim të dëmtuar³⁴. Iniciativa për Partneritet të hapur qeveritar - Kuvendi i hapur parasheh zhvillimin e një ueb-faqeje të re për tejkalimin e këtyre gjendjeve, por në këtë proces me rëndësi thelbësore do të jetë transferimi i suksesshëm i historisë së informatave tashmë të publikuara në ueb-faqen ekzistuese.

MEKANIZMAT PËR KOMUNIKIM ME QYTETARËT DUHET TË PROMOVOHEN MË SHUMË

Treguesit për bashkëveprimin e Kuvendit me qytetarët shënojnë rënie prej 64% në 47% në vitin e fundit, që është një informatë alarmuese. Hulumtimi tregon se qytetarët janë të ndarë për sa i përket njohurive të tyre për punën e Kuvendit, gjegjësisht se 49% e qytetarëve janë të njohur pjesërisht ose plotësisht, ndërsa 50% janë të njohur pak ose aspak me punën e deputetëve³⁵. Qytetarët shpesh përdorin media tradicionale për t'u informuar mbi punën e Kuvendit, ndërsa vetëm 3% e përdorin kanalën parlamentar si burim të informatave.³⁶ Befason fakti se asnjë nga të anketuarit nuk mer informatave përmes ueb-faqes së Kuvendit.³⁷

HAPAT E VEPRIMIT

- 🗨️ Parlamenti duhet t'i publikoj rrogat e deputetëve dhe kompensimin e kërkuar për shpenzime të udhëtimit.
- 🗨️ Kuvendi duhet ta përmirësojë shkallën e hapjes së organeve të punës (komisioneve) duke e publikuar praninë e deputetëve në mbledhje, duke publikuar procesverbal dhe video, si dhe duke e publikuar mënyrën e votimit të deputetëve.
- 🗨️ Video-incizimet e mbledhjeve duhet të publikohen në ueb-faqen e Kuvendit.
- 🗨️ Praktika e miratimit të ligjeve me procedurë të shkurtuar duhet të kufizohet vetëm në kushtet e parapara, pasi që afatet e shkurtuara e zvogëlojnë edhe më shumë mundësinë për procese cilësore të konsultimit.

34 Po aty

35 Kuvendi nën thjerrë: Anketë për perceptimet e qytetarëve dhe Raporti për cilësinë e debatit.
<https://bit.ly/30UCNmk>

36 Po aty

37 Po aty

Kuvendi duhet të punojë për t'i përmirësuar kontaktet me qytetarët për ta përmbushur rolin e tyre të plotë si organ më i lartë përfaqësues i qytetarëve.

- ☒ Kuvendi duhet ta marrë seriozisht angazhimin e tij për Partneritet të hapur qeveritar - iniciativa për kuvend të hapur dhe procesi i konsultimit duhet të jetë i garantuar dhe i detyrueshëm, e jo zgjedhor.
- ☒ Kuvendi duhet t'i publikojë rregullisht procesverbalet e mbledhjeve të organeve të punës dhe ta unifikojë strukturën e procesverbaleve, të cilat në praktikë nuk janë në përputhje me dispozitat e Rregullore për punë të Kuvendit.
- ☒ Kuvendi duhet ta zhvillojë praktikën e publikimit të raporteve përfundimtare dhe/ose gjysmë-vjetore të shpenzimeve të buxhetit, llogarinë përfundimtare të buxhetit dhe buxhetit qytetar, në ueb-faqen e tij. Ata gjithashtu duhet t'i postojnë këto dokumente si linke deri te ueb-faqja e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, ku publikohen deklaratat e pasurive të deputetëve, si dhe deri te sistemi elektronik për furnizime publike.
- ☒ Ueb-faqja e Kuvendit duhet të përmbajë informacione për personin përgjegjës për qasje në informatat me karakter publik.
- ☒ Lista e informatave me karakter publik duhet të azhurnohet dhe të publikohet në ueb-faqen e Kuvendit.
- ☒ Kuvendi duhet të punojë për t'i përmirësuar kontaktet me qytetarët për ta përmbushur rolin e tyre të plotë si organ më i lartë përfaqësues i qytetarëve.
- ☒ Dizajni i ueb-faqes së re duhet të ketë për qëllim lehtësimin e kanaleve për komunikim me qytetarët dhe ta inkurajojë pjesëmarrjen e tyre. 2.3.



GJYQËSIA

PËRFUNDIMET KRYESORE

SHKALLA E HAPJES E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Për vite me radhë, vlerësimet e sistemit të drejtësisë dhe sundimi i të drejtës në raportet ndërkombëtare kanë hasur ngadalësim të reformave me vërejtje të veçanta për kapjen e shtetit dhe drejtësi selektive. Për herë të parë, Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2018 shënoi përparim të mirë në zbatimin e reformave të sistemit të drejtësisë bazuar në Strategjinë për Reforma në Sektorin Gjyqësor³⁸. Kryesisht vlerësime pozitive për pavarësinë e gjyqësorit u dhanë nga Komisioni Evropian në vitin 2019, para së gjithash, për shkak të ndryshimeve të shumta legjislative në këtë fushë, në përputhje me udhëzimet e dhëna në prioritetet e reformave urgjente për vendin edhe nga Komisioni i Venecias.³⁹ Edhe shoqëria civile dha notë pozitive në lidhje me transparencën e proceseve legjislative, inkuadrimit e palëve të përfshira dhe shoqërisë civile, si dhe vlerësimin e cilësisë së ligjeve dhe politikave të propozuara⁴⁰. Sidoqoftë, transparenca aktive e organeve gjyqësore, sipas të dhënave nga ky studim, mbetet e ulët.

Për dallim nga gjykatat në rajon, treguesit mesatarë të shkallës së hapjes patën rënie prej 4%, ndërsa gjykatat në Maqedoninë e Veriut u rritën me po aq përqindje. Sidoqoftë, shkalla e hapjes së gjykatave në Maqedoninë e Veriut, vlerësohet me përqindje modeste prej 43%.

Gjykatat më së miri qëndrojnë në pjesën e transparencës (50%), por ende nuk i publikojnë pagat e gjykatësve dhe informacionet për të punësuarit në gjykata.

Megjithëse pritej që prezantimi i Portalit Gjyqësor në RVM (www.vsrn.mk) në vitin 2017, të kontribuonte në unifikim më të madh të transparencës së gjykatave, hulumtimi tregon dallime të mëdha midis gjykatave. Përmbushja e treguesve për integritetin e gjykatave është në nivel më të ulët, gjegjësisht gjykatat plotësojnë vetëm 35% të treguesve sepse nuk publikojnë Kodet e Etikës në faqet e tyre të internetit. Për më tepër, vetëm tre gjykata nga mostra e hulumtimit janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse kanë realizuar trajnime për standardet e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktin e interesit.

³⁸ Analiza e zbatimit të strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018/2019, <https://bit.ly/2nr2Vri>

³⁹ Raporti i Komisionit Evropian për përparimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, <https://bit.ly/2EGrVAe>

⁴⁰ Analiza e zbatimit të strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor (2017-2022) për periudhën 2018/2019, <https://bit.ly/2nr2Vri>

Qasje në drejtësi dhe në informacione me karakter publik

Për sa i përket qasjes, gjykatat duhet të fokusohen në mos ekzistimin e mekanizmave adekuat për komunikim me grupet e cënueshme dhe mediumet. Nuk është e mjaftueshme që gjykatat të publikojnë link të veçantë dhe persona për kontakt për realizimin e të drejtës për qasje në informacione. Ata duhet të publikojnë informacionet për të cilat tashmë janë dhënë përgjigje, gjegjësisht të dorëzuara me kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Një dobësi në qasje është mungesa e një mekanizmi adekuat për komunikim me grupet e cënueshme. Në faqet e internetit të gjykatave është vendosur person për kontakt me personat me aftësi të kufizuara, por vetë faqet nuk janë të arritshme për personat me shikim të dëmtuar dhe nuk janë publikuar udhëzime specifike për të drejtat e grupeve të cënuara. Për më tepër, gjykatat publikojnë një person përgjegjës për kontakt me mediumet dhe publikun, por nuk publikojnë udhëzues se si mediumet dhe publiku mund të komunikojnë me autoritetet gjyqësore.

41 Raport nga kontrolli i realizuar për funksionalitetin e sistemit të informacionit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave nga Rregullorja e punës së gjykatave <https://bit.ly/2oeN67I>

Efikasiteti ose njoftimi me punën e gjykatave

Standardet e monitorimit dhe vlerësimit, si pjesë e parimit të efikasitetit, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, kryesisht sepse nëpërmes tyre, publiku fiton bindjet për funksionimin, efikasitetin dhe pavarësinë e gjykatave. Gjykatat në Maqedoninë e Veriut plotësojnë vetëm 41% të standardeve të deklaruara, edhe ato duhet të përmirësohen kryesisht në drejtim të publikimit në kohë të raporteve gjyqësore në portalin e vetëm gjyqësor. Gjithashtu, përkundër faktit se në RMV është vendosur Sistemi Automatizuar Kompjuterik për Menaxhimin e Lëndëve, aplikimi i tij duhet të monitorohet vazhdimisht për të kapërcyer dhe shmangur abuzimet e sistemit, të identifikuara në një raport të veçantë të vitit 2017⁴¹.

Këshilli Gjyqësor

Këshilli Gjyqësor gjatë dy viteve të kaluara ka arritur një nivel identik të shkallës së hapjes, pas një rënie të konsiderueshme në përmbushjen e treguesve të transparencës në vitin 2017. Parimi i dispozicionit i Këshillit Gjyqësor është akoma më i ulëti, me 28%. Kjo kryesisht për shkak se Këshilli Gjyqësor nuk ka kanale të mira për komunikim me qytetarët dhe mediat, nuk ka edhe udhëzues për paraqitjen e ankesave nga qytetarët



përmes portalit në internet dhe nuk ka udhëzues për media. Parimi i transparencës është gjithashtu i ulët, me 37% të treguesve që janë përmbushur, për shkak të mungesës së politikave për prokurime publike dhe mos publikimit të informacioneve për prokurimet e realizuara publike.

Këshilli Gjyqësor, të paktën në kuptimin formal, përmbush në mënyrë të kënaqshme treguesit e pavarësisë me 76%, pasi Kushtetuta e përcakton atë si një organ të pavarur; ekzistojnë kritere ligjore për zgjedhjen e gjykatësve; ka buxhetin e vet dhe kontrollin administrativ mbi Gjykatën Supreme.

Shkalla e hapjes së prokurorive në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Rezultatet e Prokurorisë Publike si pjesë e sistemit të drejtësisë janë në një nivel jashtëzakonisht të ulët, duke përmbushur vetëm 4% të treguesve të hapjes. Prokuroritë Themelore dhe të Larta ende nuk kanë faqet e tyre të internetit dhe së bashku plotësojnë vetëm 4% të treguesve, ndërsa Këshilli i Prokurorëve Publik, vetëm 32%.

Prokuroria e RMV-së është e vendosur në mënyrë hierarkike si autoriteti më i lartë mbi Prokuroritë e Lartë dhe Themelore dhe informacione të mangëta rreth tyre publikohen vetëm në faqen e asaj prokurorie.

Ashtu si në rastin e Këshillit Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë, të paktën në mënyrë formale, plotëson disa nga treguesit e pavarësisë (41%), pasi ekzistojnë kritere ligjore për zgjedhjen e prokurorëve, ndërsa ka edhe buxhetin e vet.

HAPAT E VEPRIMIT

- ☞ Qendra e Teknologjisë Informatike e Gjykatës Supreme të RMV-së dhe Këshilli i Reformave Gjyqësore, duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje përditësimit dhe publikimit të unifikuar të informacioneve nga të gjitha gjykata. Gjykatat në faqet e tyre të internetit duhet të publikojnë Kodet Etike.
- ☞ Gjykatat duhet të realizojnë aktivitete për forcimin e kapaciteteve të të punësuarve të tyre në lidhje me standardet për korrupsion dhe konfliktin e interesave.

- ☞ Gjykatat duhet t'i publikojnë pagat e gjykatësve si dhe informacionet për të punësuarit e gjykatës.
- ☞ Qendra e Teknologjisë Informatike e Gjykatës Supreme të RMV-së duhet në kohë t'i publikojë aktgjykimet dhe të sigurojë që të gjithë gjykatat të respektojnë këtë detyrim ligjor.
- ☞ Uebfaqet e gjykatave duhet të jenë të qasshme për personat me shikim të dëmtuar dhe duhet të publikohen udhëzime specifike për të drejtat e grupeve të cënueshme.
- ☞ Uebfaqet e gjykatave duhet të përmbajnë udhëzime për komunikim ndërmjet autoriteteve gjyqësore, mediave dhe publikut.
- ☞ Përveç publikimit të linkut të veçantë dhe personave për kontakt për ushtrimin e të drejtës për qasje në informacione, gjykatat duhet të publikojnë përgjigjet e dhëna të kërkesave për qasje të lirë në informacionet publike.
- ☞ Gjykatat duhet të përmirësohen kryesisht në publikimin në kohë të raporteve gjyqësore në portalin e vetëm gjyqësor.
- ☞ Ekziston nevojë serioze për të monitoruar më mirë përdorimin e Sistemit Kompjuterik Automatizuar për Menaxhimin e lëndëve gjyqësore, për të kapërcyer dhe shmangur abuzimet e sistemit.
- ☞ Duhet të aplikohen kanale të mira komunikimi të qytetarëve dhe mediave me Këshillin Gjyqësor, si dhe të krijohen dhe publikohen udhëzues për paraqitjen e ankesave dhe peticioneve nga qytetarët përmes portalit në internet, si dhe udhëzues për mediat.
- ☞ Këshilli Gjyqësor duhet të publikojë informacione në lidhje me prokurimet publike në faqen e tyre në internet.
- ☞ Prokuroria duhet të marrë në konsideratë rekomandimin për krijimin e uebfaqeve të veçanta për Prokuroritë Themelore dhe të Lartë ose të krijojë një faqe të vetme (të përbashkët) me informacione rreth tyre.



2.4. NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE (KOMUNAT) NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

PËRFUNDIMET KRYESORE

Njësitë vendore lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmbush vetëm 25% të treguesve të shkallës së hapjes, që është shumë më poshtë se mesatarja në rajon dhe tregon një nivel të ulët të angazhimit dhe përkushtimit të komunave për përmbushjen e standardeve të hapjes. Ky indeks tregon gjendjen alarmante të shkallës së hapjes së pushtetit vendor, duke pasur parasysh thelbin e ekzistencës së komunave ku ata duhet t'u shërbejnë qytetarëve; transparenca të bazohet në të dhëna dhe informacione të hapura; të kenë procedura të qarta për pjesëmarrje në vendimmarrje, si dhe procedura të qarta për sigurimin e shërbimeve publike; por edhe për të dhënë llogari për çka i kanë shfrytëzuar paratë publike në dispozicion dhe si e kanë përmirësuar jetën e komunitetit⁴².

Për herë të katërt me radhë, Partneriteti i Hapur Qeveritarë (2018-2020) e miratoi prioritetin "Transparenca në nivelin lokal", dhe parasheh një sërë angazhimesh⁴³. Sidoqoftë, për të kapërcyer situatën alarmante në pushtetin vendor, është e nevojshme të hiqet rreziku i identifikuar më parë për qëndrueshmërinë e nismave të Partneritetit për Qeveri të Hapur të ndërmarra në nivel lokal, gjegjësisht të planifikohen fonde për komunitet për të zbatuar angazhimet e përcaktuara.

Parimi i transparencës, i cili nënkupton që informacionet për procedurat organizative, buxhetin dhe procedurat e prokurimit publik të jenë në dispozicion dhe të jenë të qasshme publikisht në faqet e internetit të komunave, përmbushet me 31%. Megjithatë, për sa i përket transparencës së buxheteve, duhet të theksohet që nuk ka praktikë zyrtare të publikimit të vazhdueshëm të buxheteve të sjella në tre vitet e fundit në formate të mbrojtura PDF⁴⁴, publikim të raporteve gjysmë-vjetore të ekzekutimit të buxhetit, si dhe nuk ka praktikë të publikimit të Buxhetit Qytetar⁴⁵, gjë që ua vështirëson qytetarëve të kuptojnë të ardhurat dhe harxhimet gjatë vitit.

Kur analizojmë parimin e qasjes, i cili përfshin respektimin e procedurave dhe sigurimin e qasjes së lirë në informacione, si dhe transparencën aktive dhe mundësinë e sigurimit të informacioneve përmes mekanizmit

42 Standardet për transparencën, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal në vend janë përcaktuar në disa dokumente: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Qasje të Lirë në Informatat Publike, Kodi i Etikës për Zyrtarët Lokal, Kodi i Etikës për Nëpunësit Civil, Ligji për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin për Konfliktin e Interesit, etj.

43 Plani Nacional i Veprimit për Partneritet të Hapur Qeveritarë (2018-2020) i qasshëm në <https://bit.ly/2lB8W3l>

44 Format i transmetueshëm për dokumente.

45 Dokument për buxhetin e destinuar për opinionin joprofesional.

të konsultimit dhe ndërveprimit publik me qytetarët, komunat plotësojnë një përqindje modeste, përkatësisht 19% të treguesve. Në fakt, plotësimi i ulët i treguesve është rezultat i asaj që komunat nuk i publikojnë planet, thirrjet, as raportet nga konsultimet publike me palët e përfshira, që përmbajnë sqarime me shkrim për propozimet, që janë pranuar ose refuzuar, as edhe propozim-projekte nga organizatat qytetare, të përcjella me kriteret e zgjedhjes dhe listat përkatëse.

Komunat më dobët i plotësojnë treguesit e efikasitetit me 14%, që përbëhet nga nënkategoritë e monitorimit dhe vlerësimit të politikave, ku plotësojnë 5% të parëndësishëm të treguesve, nënkategorinë e planifikimit strategjik, ku plotësojnë vetëm 8%, dhe nënkategorinë e raportimit në Këshille Komunale ku plotësohet një përqindje e lartë prej 95%. Plotësimi i treguesve për efikasitet është për 3.5 herë më i ulët se mesatarja rajonale e plotësimit të indeksit të efikasitetit të komunave që është 49%.

Komunat vlerësim më të mirë kanë për sa i përket nënkategorisë së indeksit që ka të bëjë me raportimin në Këshillin Komunal për shkak të detyrimit ligjor të komunave për të zhvilluar programe vjetore të punës dhe për shkak se ndërmarrjet publike dhe kryetarët e komunave janë të detyruar të raportojnë në Këshillin Komunal për punën e tyre.

HAPAT E VEPRIMIT

- ☞ Komunat duhet të publikojnë rregullisht buxhetet e tyre të miratuara në tre vitet e fundit në formate të hapura, për të lehtësuar kërkimin e qytetarëve.
- ☞ Komunat duhet të përvetësojnë praktika të publikimit të raporteve gjysmë-vjetore të shpenzimeve të buxhetit dhe buxheteve qytetare përmes të cilave qytetarët do të marrin informacion të saktë mbi të ardhurat dhe shpenzimet gjatë gjithë vitit. Komunat duhet në detaje të përmirësojnë përgjegjësinë e tyre për publikimin e informacioneve për prokurimet publike, publikimin e planeve, ankesave dhe vendimeve për prokurimet publike.
- ☞ Uebfaqet e komunave duhet të përmbajnë informacione siç janë emrat, pozicionet dhe kontaktet e zyrtarëve, të ashtuquajtura organigrame komunale.



- ☞ Komunat duhet t'i publikojnë planet, thirrjet dhe raportet e konsultimeve publike me palët e përfshira, që do të përmbajnë shpjegime me shkrim të propozimeve që janë pranuar ose refuzuar.
- ☞ Uebfaqet e komunave duhet të përmbajnë thirrje për propozim-projekte nga OJQ-të, vendime për shpërndarjen e fondeve të OJQ-ve dhe listë të renditjes së rezultateve.
- ☞ Për të tretin vit radhazi, ngelet rekomandimi i dhënë në Planin Gjithëpërfshirës për Qeverisje të Mirë në Institucionet Shtetërore, që komunat të publikojnë informacione sipas detyrimeve të tyre në përputhje me Nenin 10 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione Publike.
- ☞ Uebfaqet e komunave duhet të përmbajnë informacione të sakta për kohën e caktuar për konsultime me kryetarët e KK-ve, në të cilat do të realizoheshin konsultime me qytetarët.
- ☞ Komunat duhet të përmirësojnë komunikimin e tyre me qytetarët përmes rrjeteve sociale, si dhe çdo muaj të botojnë buletinët për punën e komunave.
- ☞ Për të arritur një nivel më të lartë të integritetit, komunat duhet të publikojnë në faqet e tyre të internetit dokumentet / politikat / planet e integritetit ose ndonjë politikë tjetër të brendshme antikorrupsioni (e cila përfshin masa për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të sjelljes korruptive dhe jo-etike në komuna).
- ☞ Meqenëse vetëm 3 nga komunat e anketuara kanë miratuar strategji për zhvillim me synime të qarta zhvillimore, por edhe ato janë jo të plota, rekomandohet që të gjitha komunat të fillojnë të punojnë në miratimin strategjive zhvillimore me synime të zhvillimit të përcaktuara qartë dhe që përmbajnë afate specifike kohore, implikime buxhetore dhe trupa përgjegjës për realizimin e tyre.

3. METODOLOGJIA

Hapja është kusht kryesor për demokracinë pasi që u mundëson qytetarëve t'i marrin informatat dhe njohuritë e nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendimmarrjen efikase dhe kërkimin e përgjegjësishë nga institucionet për politikatat që i zbatojnë.

Institucionet në gjithë botën ndërmarrin aktivitete konkrete për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj qytetarëve. Për ta përcaktuar shkallën në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informata në kohë dhe të kuptueshme nga institucionet e tyre, u zhvillua një indeks rajonal i shkallës së hapjes.

Indeksi rajonal i shkallës së hapjes e mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, duke u bazuar në katër parime: (1) transparencën (2) qasja (3) integriteti dhe (4) efikasiteti.

Parimi i transparencës nënkupton se informacionet e organizatës, buxheti dhe procedurat për furnizim publik janë në dispozicion dhe se publikohen. Qasja ka të bëjë me sigurimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata dhe rritjen e qasjes në informata përmes mekanizmit të debateve publike dhe forcimit të bashkëveprimit me qytetarët. Integriteti përfshin mekanizma për parandalimin e

korrupsionit, zbatimin e Kodeve etike dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, efikasiteti, ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e politikave që i zbatojnë institucionet.

Duke i ndjekur standardet, rekomandimet dhe shembujt ndërkombëtarë të praktikës së mirë, këto parime janë përpunuar më tej përmes treguesve specifikë sasiorë dhe cilësorë që vlerësohen në bazë të disponueshmërisë së informatave në ueb-faqet zyrtare të institucioneve, cilësinë e kornizës ligjore për çështje individuale, burimeve të tjera të informatave me karakter publik dhe pyetësorëve për institucionet.

Matja është realizuar nga dhjetori i vitit 2018 deri në fund të marsit të vitit 2019. Mbledhja e të dhënave u pasua nga një proces i verifikimit të të dhënave, duke rezultuar me një gabim standard prej +/- 3%. Duke u bazuar në rezultatet e hulumtimit, zhvilluam një sërë rekomandimesh dhe udhëzimesh për institucionet.



4. PROJEKTI:

Qeverisja e mirë është thelbësore për sundimin e të ligjit. Përderisa çështjet që lidhen me korrupsionin, transparencën, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë janë vazhdimisht në fokus, ekziston mungesë e të kuptuarit të problemeve sistemore që nuk janë të mbuluara sa duhet. Projekti ACTION SEE - Përgjegjësi, Teknologji dhe Rrjet i institucioneve të hapura në Evropën Juglindore ka për qëllimi ta ngrejë vetëdijen për sfidat e këtilla duke e lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet organizatave qytetare dhe duke i konsoliduar përpjekjet strategjike për avokim për përfaqësim.

ACTION SEE ofron një platformë për dialog dhe një mjet konkret për ta matur shkallën në të cilën institucionet shtetërore i respektojnë parimet dhe standardet e qeverisjes së hapur (indeksi i shkallës së hapjes).

Qëllimi i projektit është që të rrisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në krijimin e opinionit publik, krijimin e politikave dhe pjesëmarrjen në mekanizmat e vendimmarrjes, si dhe t'i rrisë kapacitetet e shoqërisë civile për t'i adresuar çështjet e ndjeshme.

Qëllimet specifike të projektit:

- + Promovimi i një shoqërie civile dinamike që i mobilizon në mënyrë efikase qytetarët për t'i përfshirë ata në mënyrë aktive në çështje që lidhen me sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë dhe ndikimin e politikave dhe proceseve të vendimmarrjes në nivel kombëtar dhe rajonal.

- + Forcimi i mekanizmave të dialogut midis organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare dhe ndikimi në qeverisjen e mirë dhe reformat e administratës publike.

- + Inkurajimi i rrjetëzimit të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave mediatike në nivel rajonal dhe në nivel të BE-së, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive, aftësive dhe lidhjeve dhe rritjen e ndikimit të përpjekjeve të tyre për përfaqësim.

ACTION SEE është rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku për të promovuar dhe për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë të autoriteteve në rajonin e Evropës Juglindore, për ta rritur potencialin për aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, për t'i promovuar dhe për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në internet dhe për t'i ndërtuar kapacitetet dhe interesin midis organizatave të shoqërisë civile dhe individëve në rajon për përdorimin e teknologjisë në përparimin e demokracisë.

Projekti ACTION SEE, i financuar nga Bashkimi Evropian, implementohet nga Fondacioni Metamorfozis, Fondacioni Westminster për demokraci (Westminster Foundation for Democracy), Qendra për hulumtim, transparencë dhe llogaridhënie (CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability), Shoqata e qytetarëve “Zashto da ne?”, (Citizens Association Why not?) (Citizens Association Why not?), Qendra për tranzicion demokratik (Center for Democratic Transition), Të dhënat e hapur Kosovë (Open Data-Kosovo (ODK)) dhe Lëvizja Mjaft!.

5. LEXONI MË SHUMË

Shkalla e hapjes së institucioneve të pushtetit ekzekutiv
në rajon dhe në Maqedoninë e Veriut
Rekomandime për përmirësimin e gjendjes

<https://cutt.ly/brrzTEZ>

Shkalla e hapjes së kuvendeve në rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Rekomandime për përmirësimin e gjendjes

<https://cutt.ly/WrrzYwc>

Shkalla e hapjes së institucioneve të vetëqeverisjes lokale
në rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Rekomandime për përmirësimin e gjendjes

<https://cutt.ly/TrrzYQv>

Shkalla e hapjes së institucioneve të pushtetit gjyqësor në
rajon dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Rekomandime për përmirësimin e gjendjes

<https://cutt.ly/5rrzUID>

